



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 4, datë 26.02.2014

PËR

**“EMËRTIMIN “DËSHMORËT E 4 SHKURTIT” TË RRUGËS SË RE, QË LIDH
SHESHIN “WILSON” ME DIGËN E LIQENIT TË TIRANËS**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Dëshmorët e 4 Shkurtit” të rrugës së re, nga sheshi ”Wilson” deri tek Diga e Liqenit të Tiranës, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), neni 31 i “Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak” dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të grupit të këshilltarëve të LSI në Këshillin Bashkiak.

V E N D O S I

1. Të miratojë emërtimin e një prej rrugëve të qytetit të Tiranës, me emërtimin “Dëshmorët e 4 Shkurtit” të rrugës që lidh sheshin”Wilson” deri tek Diga e Tiranës.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI